

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692035383

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

aarapi@infosoftoffice.al

E-mail

Administrator Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2024/03/04

Data (viti/muaji/dita)

0692035383

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-96483-02-26-2024

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Bashkia Librazhd

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

1208832

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje kancelari

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2024/03/08

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2024/03/08

Numri i njoftimit

Kodi CPV

REF-96483-02-26-2024

30192123-930192124-630192130-1

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendimi i KPP nr.412/2022, datë 29.04.2022.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkonti pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Me dtate 26.02.2024, në sistemin elektronik të prokurimeve (app.gov.al) të Agjencisë së Prokurimit Publik, është shpallur nga autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd, , “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje kancelari”, me fond limit, 1 208 832 (nje milion e dyqind e tete mije teteqind e tridhjetë e dy) leke pa TVSH, me REF : 96483-02-26-2024

Në shtojcën 5 (Formulari i Specifikimeve teknike) të DT-së është kërkuar:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

- ? Tonerat të jenë cilësore, në përputhje me standartet CE, të jenë prodhuar në vendet europiane, sipas specifikimeve
- ? Tonerat të jenë origjinale (të vërteta) të certifikuara, të prodhuesve të pajisjes për të cilin kërkohet/ ose ekuivalent, me vule origjinaliteti, ta pahapura, jo të rimbushura, të verifikueshme nëpërmjet pullës së sigurisë, bar-kodit dhe numrit serial në rastet kur aplikohet)
- ? Tonerat duhet të kenë shiritat mbrojtës, të cilët janë element sigurie dhe hiqen me përdorimin e parë.
- ? Tonerat duhet të kenë garanci përdorimi deri në dy vjet, nga koha e hyrjes në magazinën e institucionit
- ? Tonerat duhet të kenë të gdhendur në trup emrin e tonerit përkatës të cilët janë element sigurie
- ? Tonerat /Bojerat duhet të evidentohen nëpërmjet Part Numberit përkatës pasi është elementi kryesor dallues i percaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të printerit apo fotokopjes për të cilin nevojitet.
- ? Tonerat/Bojerat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë se prodhuesit.|Genuine_
- ? Tonerat duhet të jenë të reja, të paperdorura, të mbeshjtjelle me qese, dhe të ambalazuara në kuti, të shoqeruara me pulla sigurie nga prodhuesi. Tonerat duhet të plotesojnë të gjithë elementet e sigurisë dhe do të kryhet kontroll rigoroz, për plotesimin e këtyre elementeve.
- ? Tonerat për printer dhe fotokopje duhet të plotesojnë sasinë e faqeve sipas datashet-in dhe katalogun përkatës të pajisjeve.
- ? Tonerat inkjet duhet të kenë datë skadence jo më pak se 1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës.
- ? Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci për mallin e ofruar si dhe ndërrimin në rast difektësh fabrikimi.

- ? Letër A4 (210x297 mm , 80 g/m², 500 fletë)
- ? Cilësi e parë me certifikatë Iso CIE
- ? Bardhësi: 152 - 160% dhe pa llustër
- ? Peshë e një fije 80 gr/m? dhe një rizme (500 fije x A4)
- ? Përmasat të jenë 210 x 297 cm
- ? Lëmueshmëria: 80 - 100 ml/min
- ? Multifunkionale - për fotokopje, printer, faks.

- ? Lagështira: 3.5 - 4.5 %
- ? Trashësia: 104 - 112 ?m
- ? Aftësia në përkulje: & gt;110mN DM
- ? Ashpërsia në përkulje: & gt;50nm CD
- ? Drita:& gt;=95 %
- ? Shkëlqimi: 101-104%
- ? Amballazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma
- ? Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in
- ? Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit
- ? Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit
- ? Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët
- ? Të plotësojë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë.
- ? Të mos jetë e ricikluar
- ? Te paraqitet nje certifikate e letres e cila pasqyron specifikimet e saj

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve 2022 – 2023 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,i ndryshuar, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

a. Kapaciteti teknik :

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra për artikujt e kerkuar ne preventiv (nga 1 cope/1 artikull) . Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së tenderit para Zyres se Protokollit te bashkise Librazhd, ato duhet të jenë të mbyllura ne kuti jo transparente të vulosur, së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bejë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave eshte kusht skualifikim.

B) oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim x

Shenim : çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar..

Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi

(Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet kontraktore kur sasi të janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

Shoqëria “Infosoft Office” SHPK, si një kompani e fushës dhe e interesuar për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi, pasi u njoh me dokumentat e tenderit, vlerëson se, një pjesë e kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike, duhet të ndryshohen.

Për këto arsye, mbështetur në pikën 1 të nenin 110 (Afatet për ankim) të ligjit 162/2020 ”Për Prokurimin publik” ku përcaktohet se: “...1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë?.”, brenda afatit ligjor, paraqet ankesën e saj si më poshtë vijon:

Në pikën 38 të nenit 4 të ligjit 162/2020 përcakton përkufizimin e specifikimeve teknike e konkretisht:

“... 38. “Specifikime teknike” janë:

b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë?”.

Në Nenin 36 (Specifikimet teknike) të LPP-së përcaktohet:

“3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b”

të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me ?do mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor., ?”

Duke u ndalur ne piken 3 te nenit 36 te ligjit per prokurimin publik, gjykojme se, ligjvenesit ka parashikuar kater metoda kryesore ne hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e pare lidhet me kerkesat funksionale ose te performances, perfshire karakteristikat mjedisore, me kusht qe parametrat te jene te sakte ne menyre qe tËu japin munde si ofertuesve te percaktojnë objektin e kontrates dhe autoriteteve ose enteve kontraktore te japin kontraten.

Metoda e dyte mbeshtet ne standardet kombetare, qe mbeshteten ne ato nderkombetare, miratimeve teknike nderkombetare, specifikimeve teknike te pergjithshme, standardeve nderkombetare apo sistemeve te tjera teknike te referimit, te percaktuara nga organet nderkombetare te standardizimit. Kur keto nuk ekzistojne, ato u referohen standardeve kombetare, miratimeve teknike kombetare ose specifikimeve teknike komb?tare, qe lidhen me projektimin, perlllogaritjen dhe ekzekutimin e puneve ose perdorimin e produkteve.

Metoda e trete perfshin kerkesat ne termat funksional sipas metodës se pare, por referuar specifikimeve teknike te hartuara sipas metodës se dyte, si nje menyre qe nenkupton pajtuesheri me kerkesat funksionale, si edhe te dyja metodave te percaktuara ne shkronjat a dhe b te pikës 3 te nenit 36 te ligjit per prokurimin publik, per mallra, shërbime ose punëve të ndryshme, te perfshira ne te njejtin objekt kontrate. ?cdo referenc duhet te shoqerohet nga fjalet ose ekuivalenti i tij/saj. Ne hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe ne dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qellimi i normes juridike), arrijme ne perfundim, se e rendesishme eshte qe permes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor te mundesoje nje konkurrim te drejte, te hapur, e gjithëperfshires, te barabarte dhe jo diskriminues per te gjithë operatorët ekonomike, si edhe te mos drejtohen drejt nje produkti te vetem te ofruar nga nje operator i vetem ose nga nje numer i kufizuar operatorësh.

Në vendimet e tij Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur qëndrimin se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe ka për detyrë të mirë argumentojë vendosjen e parametrave , specifikimeve teknike dhe kriterëve kualifikuese.

Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriterë apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një numër të kufizuar produkte, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik dhe se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike duhet të evitohet përcaktime fikse apo vlera të larta.

I- Në lidhje me specifikimet teknike :

Eshte kerkuar:

- Tonerat të jenë cilësore, në përputhje me standartet CE, të jenë prodhuar në vendet europiane, sipas specifikimeve.

Sic dihet, vendi I prodhimit te produkteve, quhet vendi I origjines se tyre. Me kete kerkese, AK ka vendosur nje kufizim te origjines se produkteve, duke u kufizuar vetem ne produkte me origjine europiane, ne kundërshtim kjo me parashikimet ligjore percaktuar ne LPP.

Kerkojme heqjen e ketij kufizimi

Eshte kerkuar

-Tonerat duhet te kenë shiritat mbrojtës, te cilët janë element sigurie dhe hiqen me përdorimin e -pare

-Tonerat duhet te kenë te gdhendur ne trup emrin e tonerit perkates te cilët janë element sigurie

-Tonerat/Bojerat duhet te permbajne pullen e sigurise se prodhuesit. |Genuine

-Tonerat duhet te jene te reja, te paperdorura, te mbeshtjelle me qese, dhe te ambalazhuara ne kuti, te shoqeruara me pulla sigurie nga prodhuesi. Tonerat duhet te plotesojne te gjithe elementet e sigurise dhe do te kryhet kontroll rigoroz,per plotesimin e ketyre elementeve

Kerkesat e evidentuara me sipër, nuk jane te lidhura me funksionalitetin e tonerave, por jane parametra qe kane te bejne me politikat qe perdorin prodhuesit lidhur me ambalazhimet e produkteve te tyre. Eshte e pamundur per ne si OE, t'u diktojme prodhuesve te tonerave, kerkesa qe nuk kane lidhje me funksionalitetin e produkteve. Vendosja e ketyre kerkesave, kufizon ne menyre te ndjeshme konkurrencen, duke penalizuar te gjithe ata prodhues, qe prodhojne tonera me parametra te larte te cilesise, por qe nuk kane zgjedhur :

- Te kene gdhendur ne trup emrin e tonerit, apo
- Te vendosin shirit mbrojtës, apo
- Te vendosin pulla sigurie , Genuine
- T'i shoqerojne me pulle sigurie tonerat e prodhuara prej tyre.

Gjithashtu, edhe ne PV e argumentimit te specifikimeve, AK nuk ka arritur te argumentojte se perse vendosja e ketyre parametrave eshte e domosdoshme dhe luan rol ne performancen e produkteve.

Per kete arsye , kerkojme modifikimin e specifikimeve teknike te mesiperme, duke pranuar tonerat, sic prodhohen nga prodhuesit, pra , te shtohet shprehja “ ne rastet kur aplikohet nga prodhuesi”

Kjo kerkese e jone, mbeshtetet edhe ne shume vendime te Komisionit te Prokurimit Publik, i cili ka gjykuar te drejta pretendime te tilla ngritur nga OE ne raste te ngjashme.

- Per artikullin Leter A4, eshte kerkuar:

? Bardhësi: 152 - 160% dhe pa llustër

? Lëmueshmëria: 80 - 100 ml/min

? Aftësia në përkulje: >110mN DM

? Ashpërsia në përkulje: >50nm CD

Specifikimet e mesiperme, jane kufizuese, diskriminuese dhe nuk garantojne te drejten e OE te interesuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi. Keto kritere nuk e justifikojne qellimin per te cilin jane vendosur, pasi nuk garantojne cilesine dhe standartin e larte , per kete produkt. AK, ne hartimin e specifikimeve teknike, krahas pershkrimit te sakte te nevojave , duhet te kene ne vemendje faktin, qe specifikimet teknike, duhen bere ne menyre gjithperfshirese, duke krijuar kushte per konkurrim te paaneshem e te hapur, ndermjet te gjithe kandidateve ofertues, duke

pershkruar sakte dhe plote karakteristikat e mallrave, ne perputhje me objektin e kontrates.

Neni 36, pika 2 i LPP nr 162/2020, percakton qarte se :

“Specifikimet teknike duhet te mundesojne trajtim te barabarte per te gjithë kandidatet ofertues dhe te mos sherbejne si pengese per konkurrencen e hapur ne prokurimin publik. “

Ne respekt te ketij parimi, specifikimet teknike, ne asnje rast, nuk duhet te perjashtojne apo diskriminojne operatorët ekonomike ofertues. Ato duhet te shmangin cdo forme diskriminimi, qofte te dukshme apo te fshehta, te cilat kane te njejtin efekt. Ato nuk duhet te hartohen ne nje menyre te tille, qe te cojne drejt nje produkti te caktuar, qe ofrohet nga nje operator i vetem ekonomik, apo nga nje prodhues i vetem.

AK duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknikë kufizues e përjashtues.

Parametrat e mesiperme,jane te pajustificuara ne PV argumentues te AK..

Ne keto kushte , kerkojme

ndryshimin e parametrave

? Bardhësi: 152 - 160% dhe pa llustër

? Lëmueshmëria: 80 - 100 ml/min

Duke hapur diapazonin e parametrave si ne minimum edhe ne maksimum

Lidhur me parametrat e meposhtem,

? Aftësia në përkulje: >110mN DM

? Ashpërsia në përkulje: >50nm CD

argumentojme :

Jane te ekzagjeruara, diskriminuese dhe nuk i sherbejne qellimit per te cilin kerkohet perdorimi i ketij artikulli, nuk jane ne proporcion me natyren dhe vleren e kesaj procedure prokurimi.

Specifikimet teknike qe jane te rendesishme per letren dhe qe lidhen me cilesine e saj (si trashesia, lageshtia apo bardhesia), nga ana e AK nuk jane kerkuar, nderkohe qe jane kerkuar keto dy specifikime qe jane vetem kufizuese dhe nuk i permbajne pjesa me e madhe e skedave teknike te letrave. Kompania jone eshte distributore e disa prej fabrikave (kompanive) me te medha ne bote prodhuese te letres si : Asia Pulp & Paper, April, Indah Kiat Pulp and Paper, Fabriano, Navigator etj, ku secili prej tyre prodhon lloje (marka) te ndryshme letrash dhe pjesa me e madhe e skedave teknike te tyre, nuk i permbajne keto dy parametra. Konfirmojme qe specifikime te tilla , te cojne drejt nje produkti shume konkret , duke kufizuar keshtu ndjeshem konkurrencen. Specifikimet “Aftësia në përkulje” dhe “Ashpërsia në përkulje” jane kryesisht cilësi e kartonëve për paketim (paperboard dhe carton board) dhe jo e letrës A4 qe perdoret per printim apo fotokopje. Për këtë arsye keto dy parametra nuk pasqyrohen ne skedat teknike te letrave për printim.

Edhe KPP ne disa vendime te saj, eshte shprehur per heqjen e ketyre parametrave. Konkretisht edhe ne vendimin Nr. 382/2023

Ne keto kushte, kerkojme heqjen e ketyre dy parametrave.

Lidhur me kerkesat :

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve 2022 – 2023 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivit . Shenim: Ne respektim të VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, pika 4, kjo kerkese do të konsiderohet e permbushur nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivit.

Dorezimi bilancit të vitit 2023, behet deri ne fund te muajit Mars 2024.

Kerkojme heqjen e kerkeses per bilanc te vitit 2023, pasi nuk eshte maturuar afati per dorezimin e tij.

II- Kapaciteti teknik :

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra për artikujt e kerkuar ne preventiv (nga 1 cope/1 artikull) . Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së tenderit para Zyres se Protokollit të bashkise Librazhd, ato duhet të jenë të mbyllura ne kuti jo transparente të vulosur, së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bejë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave eshte kusht skualifikim.

Kerkesa per mostra per te gjithë artikujt , eshte tejet e ekzagjeruar dhe jo ne perpjestim me objektin e prokurimit.

Lista perbehet nga 50 artikujt, ku nje pjese e mire kerkohet ne sasira shume te vogla. Paraqitja e mostrave per te gjithë artikujt, krijon kosto te panevojshme per OE te interesuar, duke kufizuar keshtu konkurrencen, ne menyre te panevojshme.

Kerkojme kufizimin e kesaj kerkese, vetem ne artikujt me perdorshmeri me te madhe, konkretisht, per sasi me te medha se 200cope.

- Ne DST, jeni shprehur:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Shenim : çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar..

Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi

(Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

Por per sa kohe, vleresimi do te behet “me vlerën totale më të ulët të ofruar”.., kerkesa per shumatore te cmimeve per njesi, eshte e tepert, e ekzagjeruar dhe ne kundertshtim me LPP dhe rekomandimet e APP dhe KPP.

Kerkojme heqjen e shumatores se cmimeve per njesi.

Tek specifikimet teknike art:

8 Zarfa te vegjel 11X25 cope 3,000 Permasat standarte per kete lloj zarfi jane 11cm x 23cm. Permasat e vendosura nga ana juaj 11 x 25 jane jashte standari dhe per rrjedhoje kufizojne konkurrencen. Kerkojme qe te caktohet nje diapazon i permasave 11cm x 23-25cm.

Nr. 22 Kapse Binder clips 50 mm

Ju bejme me dije, se kjo permase nuk ekziston. Permasa standarte eshte 51mm.

Ju lutem, korrigjoni permasen

Nr. 23 Kapse Binder clips 40 mm

Ju bejme me dije, se kjo permase nuk ekziston. Permasa standarte eshte 41mm

Ju lutem, korrigjoni permasen

28 Epson L1200 cope 2 Verifikoni modelin e pajisjes, pasi ky qe keni percaktuar nuk eshte i sakte. Jepni modelin e sakte te pajisjes.

42 Kyocera Task Alfa cope 2 Percaktoni sakte modelin/numrin e pajisjes, pasi keni dhene vetem marken. Pa na dhene modelin e pasjisjes, eshte e pamundur te kuptojme se cfare boje duhet te ofertojme.

43 Xerox 7023 cope 2 Modeli i pajisjes qe keni dhene nuk eshte i sakte (nuk egziston). Jepni modelin e sakte dhe te plote te pajisjes.

44 Sharp cope 3 Percaktoni sakte modelin/numrin e pajisjes, pasi keni dhene vetem marken. Pa na dhene modelin e pasjisjes, eshte e pamundur te kuptojme se cfare boje duhet te ofertojme.

50 Shenjues neon cope 100 Nuk jemi te qarte se cfare kerkoni per kete artikull. Publikoni ndonje foto ose percaktoni specifikimet teknike te artkullit.

- Tek Shtojce nr.5, eshte kerkuar:

“Operatorie ekonomik i shpallur fitues duhet te dorezoje sasine e mallrave object prokurimi per cdo rast sipas kerkeses se AK, ne sasine e kerkuar sipas preventivit bashkangjitur DST dhe ne cilesine e percaktuar ne DST. “

Lidhur me kete kerkesë, kerkojme te percaktohet afati i levrimit per cdo minikontrate, per te mos pasur paqartesi dhe per te mos u bere objekt interpretimi ne momentin e lidhjes se minikontratave. Dukeqenese jemi ne kushtet e marreveshjes kuader, ku nuk jane te percaktuar sasite, afati i levrimit duhet te jete 30 dite.

Ju lutem , percaktoni kete afat.

Të nderuar,

Në nenin 2 (Qëllimi) të ligjit 162/2020 përcaktohet si vijon:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficiency dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 (Parime të përgjithshme) të ligjit 162/2020 përcaktohet si vijon:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

Pretendimet dhe kërkesat tona janë në përputhje të plotë me qëllimin e ligjit dhe me parimet e përcaktuara më sipër në legjislacionin e prokurimit publik dhe për më tepër nxitin dhe rrisin numrin dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit public, duke sjellë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Nuk ka

7. Lista e informacionit konfidencial:

Nuk ka

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

aarapi@infosoftoffice.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Frederik Prodani